



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 128, datë 23.12.2013

MBI

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe të nenit 55, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve të nenit 2.1, të nenit 5 dhe të strukturës aksionare, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., sipas tekstit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI

1. Ndryshimin e nenit 2.1, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., si më poshtë:

Ishte:

Neni 2-Selia

2.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Sulejman Delvina, Zayed Bussines Center, Tiranë, Shqipëri.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë ose me miratim të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, jashtë vendit nëpërmjet degëve dhe zyrave të saj të përfaqësimit.

Bëhet:

Neni 2-Selia

2.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Pjetër Bogdani, Nr. 40, Tiranë, Shqipëri.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë ose me miratim të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, jashtë vendit nëpërmjet degëve dhe zyrave të saj të përfaqësimit.

2. Ndryshimin e nenit 5, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., si më poshtë:

Ishte:

Neni 5- Kapitali aksionar

Kapitali i Shoqërisë i nënshkruar dhe paguar tërësisht në një vlerë prej 396.216.000 Lekë (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë Lekë) i përbërë nga 396.216.000 aksione me vlerë nominale prej 1 Lek (një) secila (këtej e tutje referuar “Aksione”). Në momentin e nënshkrimit të këtij Statuti, aksionet e Shoqërisë janë nënshkruar dhe paguar tërësisht në para nga Aksionarët, si tregohet në Shtojcën 1 bashkëlidhur këtij Statuti, si pjesë përbërëse e tij.

Bëhet:

Neni 5- Kapitali aksionar

Kapitali i Shoqërisë i nënshkruar dhe paguar tërësisht në një vlerë prej 676.636.000 Lekë (gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë Lekë) i përbërë nga 676.636.000 aksione me vlerë nominale prej 1 Lek (një) secila (këtej e tutje referuar “Aksione”). Në momentin e nënshkrimit të këtij Statuti, aksionet e Shoqërisë janë nënshkruar dhe paguar tërësisht në para nga Aksionarët, si tregohet në Shtojcën 1 bashkëlidhur këtij Statuti, si pjesë përbërëse e tij.

3. Miratimin e strukturës aksionare, si më poshtë:

Aksionari i shoqërisë	% e zotërimit	Nr. i aksioneve aktualisht zotëruara	Kapitali i nënshkruar pas rritjes (Lek)
Vienna Insurance Group	93.1683	630,410,801	630,410,801
Shefikat Ngjela	4.8797	33,017,999	33,017,999
Elvana Mino	0.9759	6,603,600	6,603,600
Tonin Troqe	0.9759	6,603,600	6,603,600
Totali	100	676,636,000	676,636,000